



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 060-8448 /22

Klinë, dt: 15.03. /22

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 14.02.2022, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e komitetit, drejtorët dhe gjithë të pranishmit, gjithashtu i uroi të gjithë anëtarët pér një fillim të mbarë të mandatit. Theksoj se përvèç pikave të cilat janë pér shqyrtim në rend dite, kemi edhe një kërkesë pér një pikë shtesë e cila është kërkuar nga drejtoria e shërbimeve publike.

Kërkesë pér shfuqizimin e vendimit pér shpalljen “Zonë e Veçantë me Interes Publik”, parcelën nr. P-71010080-00109-2, ZK Çabiq dhe futjen në rend të ditës marrjen e vendimit pér shpalljen “Zonë e Veçantë me Interes Publik”, parcelën nr. P-71010080-00109-4, ZK Çabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashota, ku planifikohet të ndërtohet rezervuari akumulues pér furnizim me ujë të pijshtëm me kapacitet 1000m<sup>3</sup> ujë. Arsyja e shfuqizimit të vendimit të parë pér “Zonë të Veçantë me Interes Publik”, është se parcela në fjalë ka qenë rreth 9848m<sup>2</sup>, ndërsa ne si komunë kemi nevojë pér parcelën prej 1527m<sup>2</sup>. Konzorciumi DORCH/CDI ka hartuar projektin detal si dhe ka ndarë buxhetin e nevojshëm në vlerë prej 1,500,000.00 € pér ndërtimin e ujësjellësit pér 11 fshatra të Komunës së Klinës.

Mbi këtë gjendje kërkojmë nga Kuvendi i Komunës, që në këtë seancë të futet si pikë e rendit të ditës:

1. Shfuqizimi i Vendimit nr.01-06-7775/2021 të miratuar më datën 26.02.2021 pér shpalljen e zonës së interesit publik të parcelës nr. P-71010080-00109-2, ZK Çabiq, Komuna e Klinës, si dhe:

2. Marrja e vendimit pér shpalljen e “Zonë e Veçantë me Interes Publik”, parcelën nr. P-71010080-00109-4, ZK Çabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashota.

Në këtë parcelë planifikohet të ndërtohet rezervuari akumulues për furnizim me ujë të pijshëm me kapacitet 1000m<sup>3</sup> ujë, andaj me qëllim të vazhdimit të procedurave tjera ligjore deri në finalizimin e projektit, kërkojmë që vendimet e propozuara të aprovohen si të tilla.

Duhet theksuar se në parcelën e njëjtë është ndërtuar edhe një rezervuar tjetër nga Komuna e Klinës, mirëpo nuk është arritur që të funksionalizohet për mungesë të burimit të ujit, ndërsa me projektin e ri do të jetë në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe pjesë e projektit në zhvillim.

Më pas, kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2021,
3. Shqyrtimi i kërkesës së drejtorisë për F.E.ZH. për rritje të buxhetit për vitin 2021 dhe bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe M.M për ndarje të parcelës për ndërtim të objektit për zjarrfikës,
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për formimin e këshillit organizativ të festivalit "I këndojmë lirisë",
6. Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2021,
7. Shqyrtimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2022,
8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin Janar-Shkurt 2022,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi debat rrëth rendit të ditës, bashkë me kërkesën e parashtruar nga DSHPE, pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës.

**Me 7 vota PËR u miratua rendi i ditës së bashku me kërkesën e parashtruar për shqyrtim nga drejtoria e shërbimeve publike.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Z.Fadil Gashi, kryesues: Të gjithë anëtarët e komitetit janë prezent.**

**Pika 2. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Dhjetor 2021**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Sa i përket kësaj pike, unë po i jap fjalën drejtorit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim z. Aziz Desku, urdhëroni!

**Z.Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH:** Faleminderit kryesues, raporti për periudhën janar-dhjetor 2021, është përgatitur në pajtim me nenin 45 paragrafi 45.2 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L- 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitet. Raporti i përgatitur paraqet buxhetin në SIMFK, shpenzimet dhe arkëtimin e të hyrave.

Buxheti për këtë periudhë ishte 11,634,795.16 €, siç shihet nga tabela më lartë buxheti sipas SIMFK për janar- dhjetor 2021 është më i ulët përrreth 0.73 % se buxheti në periudhën e njëjtë të vitit 2020 .

Granti Qeveritar në vlerë prej 10,223,170.63 € është burimi kryesor i financimit të buxhetit komunal, 87.87% e buxhetit total në këtë periudhë, në raport me vitin paraprak buxheti nga Granti Qeveritar është 1.9 % më i ulët.

Të hyrat vetanake, siç shihet edhe në tabelë buxheti nga THV të vitit 2021 ku vlera e planifikuar ka qenë 830,437.00 € (7.14 % e buxhetit total në këtë periudhë). Ndërsa në raport me vitin paraprak buxheti nga THV është më i ulët përrreth 9.25%. Të hyrat e bartura janë 554,975.41 € (4.77 % e buxhetit total në këtë periudhë). Në raport me vitin paraprak janë më të larta përrreth 53.47 % .

Donacionet përvèç Grantit Qeveritar dhe THV si burime të rregullta të financimit ,si burim të financimit në këtë periudhë kemi edhe donacionet, siç janë :

- Participimi i qytetarëve në vlerë 21,212.12 € (0.18 % e buxhetit total në këtë periudhë), në raport me vitin paraprak buxheti nga participimet me qytetarë është rreth 4.6 % më i ulët se në vitin paraprak .

- Donacioni nga Save the Children është 5,000.00 €

- Buxheti i shpenzuar janar-dhjetor 2021 në vlerë prej 11,134,681.61€ është 95.7% e buxhetit për vitin 2021.

Nga granti qeveritar janë shpenzuar 10,089,467.21 €, nga të hyrat vetanake 542,080.30 € (65.28 % në raport me buxhetin nga të hyrat për 2021), nga të hyrat e bartura 482,004.10 € (86.85 % në raport me buxhetin nga të hyrat e bartura), nga participimi i qytetarëve 16,130.00 € (76.04% në raport me buxhetin nga participimet me qytetarë) dhe nga Save the Children 5,000.00 €(100 % në raport me buxhetin nga ky donacion) .

Ndërsa nga totali i buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë në vlerë 11,134,681.61 € nga granti qeveritar janë 90.61%, nga të hyrat vetanake 4.87 % , nga të hyrat e bartura 4.33% , nga participimi i qytetarëve 0.14 % dhe nga Save the Children 0.04% .

Shpenzimet e buxhetit në këtë periudhë janë më të larta përrreth 2.75 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak .

Nga buxheti i shpenzuar në periudhën janar – dhjetor 2021 në vlerë 11,134,681.61 € për paga dhe mëditje janë shpenzuar 6,700,218.13 € (60.17 % e shpenzimeve ), përmallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,211,429.32 € (10.88 % e shpenzimeve ), për shërbime komunale 179,398.69 € (1.61 % e shpenzimeve ), për subvencione 345,108.59 € (3.10 % e shpenzimeve ) dhe përkapitale 2,698,526.88 € (24.24 % e shpenzimeve ).

Ndërsa sa i përket të hyrave vetanake të vitit 2021 Komuna e Klinës ka arritur një rekord të ri në krahasim të të hyrave me vitet paraprake.

Komuna ka inkasuar gjithsej 1,675,600.05 € të hyra në periudhën janar – dhjetor 2021.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak të hyrat janë më të larta përrreth 69.88 % ose në vlerë përrreth 689,274.47 €. Ky ishte një prezantim i shkurtër sa i përket këtij raporti, nëse ka dikush ndonjë pyetje, urdhëroni. Faleminderit!

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Hapi debat rrreth raportit finanziar për periudhën janar-dhjetor 2021.

**Z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje për të gjithë, unë e dëgjova me vëmendje drejtorin, disa shifra nuk po përputhen me raportin të cilin ne e kemi!

**Z. Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH:** Tunë, unë nuk i përmenda shifrat me centë, e aty ishte dallimi por raporti është i njëjtë siç e vërtetuam së bashku.

-Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje tjetër apo sugjerim, KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR -Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që raporti financiar Janar-Dhjetor 2022, të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

**Pika 2.** Shqyrtimi i kërkesës së drejtorisë për F.E.ZH. për rritje të buxhetit për vitin 2021 dhe bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Kjo kërkesë për shtim të buxhetit dhe për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake, ka arritur në komitet nga drejtoria për financa, ekonomi dhe zhvillim, unë edhe për këtë po i jap fjalën drejtorit. Urdhëroni drejtor!

**Z. Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH:** Propozim- vendimi për rritje të buxhetit është pak a shumë formal, siç e dini të hyrat vetanake nga gjobat e trafikut dhe dënimet e gjykatave, nga viti 2019 nuk planifikohen si të hyra të komunës edhe pse ne ato i shfrytëzojmë.

-Të hyrat vetanake të realizuara për vitin 2021 kanë qenë 1,365,338.25 euro. Të planifikuara kanë qenë 830,437.00 euro, ndërsa rritja është 534,901.25 euro. Për këtë duhet të merret vendim për shtim të buxhetit.

Ndërsa vlera e mjeteve të cilat do të barten në buxhetin e vitit 2022 do të jetë: 1,196,666.06, këtu hyjnë edhe gjobat e trafikut, gjykatave dhe mjetet e pa shpenzuara nga viti paraprak. Vetëm ka mbetur për tu harmonizuar edhe njëherë me ministrin e financave, por ne konsideroj se kjo do të jetë vlera.

Ne kemi planifikuar që shuma prej 115,000.00 euro të bartet tek kategoria paga dhe mëditje, kryesisht në drejtorinë e arsimit me qëllim të pagesës së obligimeve nga kontratat kolektive konkretisht për shujta.

Mallra dhe shërbime 61,000.00 euro, shpenzime kapitale 984,666,06 euro dhe për subvencione dhe transfere 36,000.00 euro.

-Sa i përket bartjes së mjeteve sipas ligjit për financa, këto mjete duhet t'i bartim aty ku kemi obligime vitet e kaluara kur merret parasysh se shumica e projekteve është dy dhe tre vjeçare.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit drejtor, unë ju kisha lutar që deri në seancë të jenë edhe ndarjet e precizuara, ku edhe do të merret vendimi. Për pjesën tjetër unë po hapi debat.

**Z. Tunë Dedaj;** Faleminderit kryesues, unë kam një kërkesë për drejtorin e financave, a ka mundësi që një pjesë të ndahet për drejtorin e bujqësisë, kryesisht për subvencione dhe të parashihet që ti ndahen bujqve nga 50 euro shtesë për hektar nga komuna, pasi që çmimet e plehut dhe gjërat tjera janë rritur ekstrem.

**Z. Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH:** Ne e kemi biseduar edhe me kryetarin në bordin e drejtorëve këtë çështje, ne kemi ndarë 36,000.00 euro për subvencione tek zyra e kryetarit, 6,000.00 janë për bursa për drejtorinë e arsimit dhe shpenzime udhëtimi, ndërsa 30.000.00 euro janë tek zyra e kryetarit për subvencione ku edhe kryetari nga zyra e tij ka shprehur gatishmëri të ndaj mjete për këtë që e thua ti.

**-Pas mbarimit të këtij debati, KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR -Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kërkesa e drejtorisë për F.E.ZH. për rritje të buxhetit për vitin 2021, dhe bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 3.** Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe M.M për ndarje të parcelës për ndërtim të objektit për zjarrfikës.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Besoj se të gjithë ju e keni këtë kërkesë për inicimin e ndarjes së parcelës me nr. 01900-1- ZK – Dresnik për ndërtimin e objektit për nevoja të zjarrfikësve njësia Klinë. Nga drejtoria theksohet se kjo parcelë është pronë shoqërore e komunës e cila momentalisht shfrytëzohet nga Policia e Kosovës, por që ka një pajtim edhe me këta të fundit që kërkesa për ndarje të parcelës prej **1500m<sup>2</sup>** (15 ari) të vazhdoj më tutje procedurat për ndarje. Unë po hapi debat, nëse ka dikush diçka rrëth kësaj, urdhëroni.

**-Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që kërkesa për inicimin e ndarjes së parcelës me nr. 01900-1- ZK – Dresnik për ndërtimin e objektit për nevoja të zjarrfikësve njësia Klinë, të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 4.** Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për formimin e këshillit organizativ të festivalit “I këndojmë lirisë”.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Sa i përket kësaj pike kemi një kërkesë të parashtuar nga drejtoria e DKRS-së, për formimin e këshillit organizativ për mbajtjen e festivalit “ I këndojmë lirisë”, ku theksohet se drejtoria dhe ekzekutivi propozojnë njëmbëdhjetë anëtarë dhe po ashtu kërkohet që të emërohen edhe pesë anëtarë të tjerë nga Kuvendi për formimin e këtij këshilli organizativ në mënyrë që këshilli ta ketë përbërjen e plotë.

Ky organizim i festivalit folklorik “I këndojmë lirisë” është për çdo vit, por që dy vitet e fundit ne kemi marrë vendim për anulim që mos të mbahet festivali për shkak të pandemisë. Ndërsa këtë vit është kërkuar nga drejtoria e DKRS-së që të mbahet ky festival.

Kryesuesi hapi debat!

**-Pasi askush nuk mori fjalën, KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që kërkesa për formimin e këshillit organizativ për festivalin folklorik “ I këndojmë lirisë” të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 5.** Shqyrtimi i procesverbalit nga takimi i dytë i kryetarit të komunës me qytetarë për vitin 2021,

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne si çdo herë e kemi shqyrtuar procesverbalin nga takimi i kryetarit të komunës me qytetarë, për sot po e shqyrtojmë procesverbalin nga takimi i dytë i kryetarit të komunës për vitin 2021 i mbajtur më datë 28.12.2021.Unë po hapi debat!

**-Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që procesverbali nga takimi i kryetarit me qytetarë të kaloj për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 6. Shqyrtimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2022.**

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ky plan i punës ka ardhur për shqyrtim nga znj. Marqe Tanushi Selmanaj, nënkyetare e komunës edhe ky plan i punës së KKSB-së duhet të shqyrtohet dhe miratohet në kuvend sepse ashtu edhe parashihet me udhëzim administrativ.  
Unë po hapi debat!

**Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim, KRYESUESI hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që plani i punës së KKSB-së të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 7. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin janar-shkurt 2022**

**-Kryesuesi vazhdoi me prezantimin e kërkesave me radhë:**

**Kërkesa 1.**

Kërkesë e parashtruar nga z. Lorenc Tuqaj i cili kërkon lirim nga qiraja komunale për vitin 2021, për lokalet të cilat janë pronë e komunës në këtë rast edhe bufeja e komunës. Po ashtu thekson se deri tek kjo kërkesë ka ardhur si rezultat i mos punës dhe qarkullimit të dobët financiar.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne kemi marrë vendim vitin e kaluar për lirim nga qiraja, ndërsa për këtë vit s'e di sa jemi të gatshëm pa pasur një analizë nga drejtoria e financave dhe ekzekutivi për lirim të qirasë komunale, duke marrë parasysh që masat kanë qenë më të relaksuara sa i përket virusit Covid-19.

**Z.Aziz Desku, drejtori i F.E.ZH:** Ne për vitin 2020 i kemi liruar nga pagesat të gjitha bizneset të cilat nuk kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre. Ndërsa për vitin 2021 nuk ka pasur mbyllje, dhe po ashtu ky në këtë kërkesë ka kërkuar lirim për të gjithë. Ne pa një vendim të kuvendit nuk mund t'i lirojmë nga qiraja por që edhe nuk kemi ndonjë analizë.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne nëse marrim ndonjë vendim, vendimi duhet të jetë për të gjithë i barabartë, kurdo që arrin një analizë ku ne mund të bazohemi, atëherë edhe mund të ndërmarrim veprime në lidhje me këtë çështje.

**Z. Tunë Dedaj:** Po, është e vërtetë që nuk kanë qenë të mbyllura lokalet por që puna ka qenë e vështirësuar sado pak. Unë mendoj që ta vendosim një kusht, ata të cilët e paguajnë të gjithë tatimin menjëherë, për gjysmën tjetër të falen.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Le të vijë deri në seancë një analizë, një vlerësim i arsyeshëm ku vlerësohet edhe puna edhe gjendja e tyre dhe ne së bashku do ta shqyrtojmë dhe marrim vendimin e merituar në bazë të asaj që vlerësohet.

**-Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Lorenc Tuqaj për lirim nga qiraja komunale për vitin 2021, të dërgohet në drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, të bëhet një analiz financiare e gjendjes se tyre, me pas drejtoria ta sjell në kuvend një rekomandim rrith kësaj çështje.**

**Kryesuesi vazhdoi me prezantimin e kërkesave!**

**Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga z. Ruzhdi Agushi nga fshati Drenoc i cili thekson se bashkëshortja e tij vuan nga një sëmundje e rëndë dhe trajtimi i kësaj sëmundje ka kosto të lartë financiare, gjë e cila është e pa përballueshme për buxhetin familjar. Andaj kërkon që sipas mundësive buxhetore ti ndihmohet financiarisht.

**Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Ruzhdi Agushi të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit me rekomandim që ti ndihmohet sipas mundësive buxhetore.**

**Kërkesa 3.**

Kërkesë e parashtruar nga z. Vitor Gashi i cili kërkon që ti jepet në shfrytëzim të njësisë kadastrale Nr.00448-0 Z. K. Dobërdol, e cila është në sipërfaqe prej 169013m<sup>2</sup> në pronësi të komunës së Klinës, ku kërkohen vetëm sipërfaqja prej 10000-11000 m<sup>2</sup> (100-110 ha).

Vlen të theksohet se parcela do të përdoret për ndërtimin e një fushe të futbollit të cilën do ta ndërtoj me vetëfinancim parashtruesi i kërkesës.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ne këtë kërkesë e kemi shqyrtuar edhe njëherë mandatin e kaluar dhe e kemi refuzuar për plotësim të kërkesave ligjore, të cilat kërkohen me ligj ku parashihet që sipas ankandit të jepen këto prona në shfrytëzim.

**Kryesuesi hodhi në votim dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit dhe në drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi dhe drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të plotësohen kushtet, kriteret dhe kërkesat ligjore sipas Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe pastaj të vijë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 8. Të ndryshme.**

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Ashtu siç u dakordua më fillim të mbledhjes, pra kemi një kërkesë nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjente për shfuqizimin e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçantë me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-2, ZK Çabiq dhe futjen në rend të ditës marrjen e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçantë me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-4, ZK Çabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashotaj, ku planifikohet të ndërtohet rezervuari akumulues përfurnizim me ujë të pijshëm me kapacitet 1000m<sup>3</sup> ujë. Arsyja e shfuqizimit të vendimit të parë për "Zonë të Veçantë me Interes Publik", është se parcela në fjalë ka qenë rrith 9848m<sup>2</sup>, ndërsa ne si komunë kemi nevojë për parcelën prej 1527m<sup>2</sup>. Konzorciumi DORCH/CDI ka hartuar projektin detal si dhe ka ndarë buxhetin e

nevojshëm në vlerë prej 1,500,000.00 € për ndërtimin e ujësjellësit për 11 fshatra të Komunës së Klinës.

Kryesuesi hapi debat rreth kësaj kërkesë!

**Z. Tunë Dedaj:** Unë kam vërejtje që në kërkesën e parë që është marrë vendim për shpalljen zonë në interes publik afér një hektar, kur nuk janë nevojitur më shumë se pesëmbëdhjetë ari. Dikush duhet të përgjigjet për këto, tash, s'dihet se a pranon ajo zonja të ndahet vetëm pesëmbëdhjetë ari?

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Të them të drejtën Tunë, ne anëtarët e kuvendit nuk jemi ekspert gjeedet dhe ashtu siç na sjellin shkresat ndonjëherë i votojmë dhe mund të na qesin në lajthitje. Por në ketë rast, ne na duhet vetëm pesëmbëdhjetë ari dhe e mira është se po kërkohet zvogëlimi i sipërfaqes dhe jo rritje, ne marrim vendim në kuvend vetëm për shpallje të zonës në interes publik, procedurat e shpronësimit kryhen nga palët e tjera.

- Pas përfundimit të debatit, kryesuesi hodhi në votim kërkesën e parashtruar nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjente për shfuqizimin e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçantë me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-2, ZK Çabiq dhe futjen në rend të ditës marrjen e vendimit për shpalljen "Zonë e Veçantë me Interes Publik", parcelën nr. P-71010080-00109-4, ZK Çabiq, pronë private në emër të znj. Zelfije Bashotaj, dhe me 7 vota PËR, Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që kërkesa të kaloi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Kryesuesi më pas fjalën i dha znj. Valmire Krasniqi.

**Znj. Valmire Krasniqi:** Përrshëndetje për të gjithë, ne grapi i kuvendarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, kemi një kërkesë për rritjen e numrit të përfituesve të bursave si dhe seancën e radhës të caktohet pikë e rendit të ditës ndryshimi i rregullores për ndarjen e bursave për studentë.

**Z.Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, por ju atë kërkesë ju lutem që ta paraqitni me shkrim në sekretarinë e kuvendit, sepse ndryshimi i rregullores ka procedurë të veçantë, duke marrë vendim në kuvend për ndryshim, pastaj debat me publikun e mandej të miratohet në Kuvend. Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar, ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë, me kaq po e mylli mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësi,  
Ahmet Berisha



Kryesuesi,  
Fadil Gashi